

# PERMBLEDHJE JOTEKNIKE PER LEJE MJEDISI

## TIPI B PER SUBJEKTIN:

### “PREMTI” SH.P.K



**Subjekti:** “Premti” sh.p.k

**Aktiviteti:** “3.7 Nxjerrja e mineraleve, reres dhe argjiles nga minierat me shfrytezim ne qiell te hapur dhe nga guroret.

3.11 Prodhimi dhe fraksionimi i produkteve minerale jometalike”

**Vendndodhja:** Komuna Krekez, Sarande, Vlore

**Pergatiti materialin :** “Eko- Studio- Projekt” sh.p.k




Tirane, 2022

## PERMBAJTJA

- ✚ Hyrje
- ✚ Baza ligjore
- ✚ Metodika e vleresimit te mjedisit
- ✚ Objektivat dhe qellimi i VNM-se

1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT
2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI
3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS
4. MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE
5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME



## **HYRJE**

Aktiviteti njerezor qe zhvillohet ne çdo aspekt te vetin, perveç dobesive ne menyre te pashmangshme krijon dhe “produkte” qe ne perfundim mund te sjellin probleme per zhvillimin e qendrueshem te mjedisit. Pavaresisht nga vlerat dhe volumet edhe ne Shqiperi keto probleme vrojtohen dhe shoqeria e shteti kane synuar dhe vazhdojne te organizojne dhe orientojne kete proces. Ndotja e mjedisit nenkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjese te materialeve te ndryshme ne uje , toke, ajer e cila shkakton ose mund te shkaktoje probleme mjedisore te perkoheshme ose te perhershme ne balancen ekologjike te tokes. Se bashku me zhvillimin e madh qe eshte bere ne industri te ndryshme ne menyre te ngjashme me te njejten shpejtesi eshte rritur edhe sasia e mbetjeve nga perdorimi i te mirave materiale. Mbetjet industriale dhe ato urbane te patrajtuara , emetimet e gazeve te demshem ne atmosfere , perdorimi i kimikateve te reja pa marre parasysh demet qe mund ti sjellin mjedisit kane sjelle problemet mjedisore me te cilat ne perballemi ne ditet e sotme.

Ndaj eshte e nevojshme qe shoqeria te ndergjegjesohet per ta mbajtur sa me paster mjedisin ku jetojme duke marre masat e duhura per trajtimin e mbetjeve si dhe emetimin e gazeve te demshem ne atmosfere qe gjenerohen nga zhvillimi i aktiviteteve te ndryshme.

***Ndikimi → efekti i nje projekti qe ka ne mjedisin rrethues***

***Vleresimi → analiza qe i behet ketij projekti***

***Mjedisi → elementet abiotike dhe biotike***

VNM perfshin gjithashtu parashikimin dhe planifikimin e masave zbutese te ndikimeve te projektit ne mjedisin fizik dhe social me qellim permiresimin e cilesise dhe qendrueshmerise se mjedisit. Mbrojtja e mjedisit, si nje sistem dinamik, duhet pare ne teresine e faktoreve natyror, dhe te veprimit njerezor qe ushtrohen mbi te. Ato kane nje efekt te fuqishem mbi kushtet e jeteses se popullsise, dhe jane nje element baze per krijime te favorshme ekonomike.

## **BAZA LIGJORE**

Relacioni u pergatit ne zbatim te akteve ligjore dhe nenligjore Mjedisore:

- Ligji Nr.10 431, date 09.06.2011 “ Per Mbrojtjen e Mjedisit ”
- Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 « Per Lejet e Mjedisit »
- Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis »
- Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes”
- Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara”
- Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”
- Ligji nr. 8897 dt. 16.05.2002 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”
- Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”
- Vendim nr.805 date 4.12.2003 « Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis per te cilat kerkohet leje mjedisore »
- Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 « Per largimin publik te mbeturinave »
- Udhezim nr.1 date 03.03.2009 « Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjesemarrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis »
- Udhezim nr.3 date 19.11.2009 ‘Per metodologjine e raportit te VNM’
- VKM nr.419 date 25.6.2014 « Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A,B dhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mejdisit si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja ».
- Vendim Nr.13, date 04.01.2013 ” Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis ”.

## **1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT**

### ➤ **Profili i propozuesit**

Subjekti ”**Premti**” sh.p.k me administrator **Z. Fotina Premti** eshte regjistruar prane QKB me NIPT K04814846G per ushtrimin e aktiviteteve “**Nxjerrja e mineraleve, reres dhe argjiles nga minierat me shfrytezim ne qiell te hapur dhe nga guroret dhe Prodhim e fraksionim i produkteve minerale jometalike**”. Aktiviteti zhvillohet rreth 1 km ne objektin Volloderi Siper, qe ben pjesë ne komunën Krekeze rrethi Sarandë.

### ➤ **Pershkrimi i proceseve teknologjike**

#### **Te dhena te shkurtera mbi llojin e mineralit.**

Minerali qe do te shfrytezohet perfaqsohet nga gelqeror i cili mund te perdoret per prodhime inertesh te ndryshme, gelqere dhe çimento . Per te gjykuar mbi fushen e perdorimit te materialit te ketij objekti u moren prova perkatese dhe u kryen analizat kimik edhe fiziko-mekanike. Perberja kimike e gelqeroreve te analizuar ne kete vendburim eshte si ne tabelen e meposhteme:

Tabela Nr 1 Treguesit cilesore te gelqerorit te objektit:

CaO	Fe <sub>2</sub> O <sub>3</sub>	MgO	Al <sub>2</sub> O <sub>3</sub>	Na <sub>2</sub> O	K <sub>2</sub> O	SiO <sub>2</sub>	Hk
51.5 - 52.5%	0.7- 0.9%	1.1%	0.5	0.2	0.25	0.8 -1.32%	43.01%

Nga provat e studjuara per vetite fiziko-mekanike, rezulton se keta gelqerore kane karakteristikat e meposhteme :

- Lageshtia natyrale 0.6%
- Pesha specifike 2.7 gr/cm<sup>3</sup>.
- Kompaktesia 93.3%
- Poroziteti 5.1%
- Rezistenca ne shtypje ne gjendje natyrale per 19 kampione te analizuar, rezulton nga 960-984 kg/cm<sup>2</sup>.
- Pesha volumore, 2.62 gr/cm<sup>3</sup>.
- Qendrueshmeria ne terheqje 125 kg/cm<sup>2</sup>
- Qendrueshmeria ne prerje, 175 kg/cm<sup>2</sup>
- Fortesia sipas Protodiakonovit, 9.5 deri 9.7
- Kendi i ferkimit te brendshem ne kampione, φ 62° 20'

Materiali i prodhuar prej tyre mund te perdoret si lende e pare ndertimi, çakell, rere e perpunuar, gure themelesh, stabilizant ne shtrimin e rrugeve, gure ndertimi , prodhim gelqere etj.

### ***Te dhena te pergjithshme te objektit***

Objekti i gelqeroreve per te cilin kerkohet shtyrje e afatit te lejes minerare te shfrytezohet ndodhet ne lindje te qytetit te Sarandes dhe ne krahun perendimor te rruges Sarande –Vlore . Duam te theksojme se zona qe do te shfrytezohet eshte pa objekte banimi, industriale, vepra arti dhe eshte e pa pyllzuar e cila nuk perben ndonje problem per shfrytezim.

Ne siperfaqen e rilevuar jane trasuar tre profile dhe pikerisht profili I-I, II-II, III-III,IV ne rreth distance 70 m nga njeri tjetri.

Ne kete siperfaqe neper te carat e gelqeroreve jane depozituar dherat qe kane bere qe te rritet bari.

Gelqeroret kane dalje te plote ne siperfaqe vende-vende te mbuluar edhe me pak toke vegjetale ku trashesia nuk i kalon 10 cm ne pjese te vecanta

Formojne shtresa nga 20 cm e deri vende –vende blloqe masive qe arrijne deri ne 1m drejte thellesise..

Ne hartiminmin e pjeses minerare te ketij studimi, percaktimin e menyres se shfrytezimit rrathen e shfrytezimit dhe elemente te tjere, jane mare ne konsiderate :

- Topografia e objektit ne zonen e shfrytezimit dhe per rreth saj ;
- Sasia e rrezervave te nxjerreshme ne kuota ta ndryshme te vendburimit;
- Sasia e mbuleses dhe e sterialve qe duhet te zhvendosen jashte zones se shfrytezimit;
- Koeficienti mesatar i zbulimit ;
- Mundesite e lidhjes se vendburimit me rrugen nacionale
- Karakteristikat fiziko-mekanike dhe gjeomekanike te formacioneve qe ndertojne vendburimin;
- Sistemi i çarjeve, orientimi i tyre dhe materiali mbushes qe ndodhet ne to;
- Tregues te rendesishem gjeomeknke dhe gjeoteknike si RQD dhe RMR;
- Infrastruktura ekzistuese dhe permiresimet e saj ;

Ekspereienca e shfrytezimit ne zonen perreth

Sipas ketij projekti rezervat e nxjerrshme ne shkalle paraqitet ne grafikun e prodhimit te me poshtem

Pas llogaritjeve paraprake te ndara perkatesisht ne shkalle dhe treguesit e tjere, rezervat te nxjerrshme jane dhene ne tabelen e me poshteme

Tabela e llogaritjes se rezervave te nxjerrshme te objektit

Nr.	Shkalla	Siperfaqe ne shkalle	Siperfaqe mesatare	Lartesi shkalle	Rezerva,m <sup>3</sup>
1	230	605	202	3	605
2	220	3190	1897.5	10	18975
3	210	6150	4670	10	46700
4	200	9170	7660	10	76600
5	190	11270	10220	10	102200
6	180	13345	12307.5	10	123075
7	170	15880	14612.5	10	146125
8	160	18090	16985	10	169850
9	150	22900	20495	10	204950
10	140	24750	23825	10	238250
11	130	30833	27791.5	10	277915
SHUMA REZERVA					1405245

**Kapaciteti nxjerrres i minieres, regjimi i punes, nderesa ne dite, dite ne muaj, ose vit. Grafiku i punimeve te zbulimit dhe grafiku i prodhimit per gjithe minieren.**

### **Kapaciteti Prodhuar**

Prodhimi realizuar nga shfrytezimi i ketij vendburimi ne zonen e licensuar do te kete si destinacion perdorimin e tij ne industrine e ndertimit te rajonit ne forme te gureve te prodhuar direkt nga karriera dhe te materialit te perpunuar si rere, granil apo çakull si dhe prodhimin e gelqeres apo te industrise se çimentos. Per kete arsye, ne varesi te tregut te studjuar dhe te pritshshem, subjekti parashikon nje prodhim vjetor 100000 m<sup>3</sup>/vit

### **Regjimi i punes**

Per realizimin e prodhimit te parshikuar karriera do te punoje 312 dite ne vit, 25-26 dite ne muaj me nje nderese ne dite

Per vitin e pare te aktivitetit te saj karriera do te punoje me nje intensitet me te larte per realizimin e zbulimit, kryerjen e rruges se hapjes ne pjesen e poshteme, sistemimet e ndryshme dhe te prodhimit.

### **Grafiku i zbulimit dhe prodhimit**

Sasia e pergjithshme e zbulimit te kesaj karriere eshte 4241.12 m<sup>3</sup> dhe parashikohet te realizohet paralelisht me shfrytezimin ne sejcilen shkalle

Vellimi i pergjithshem i zbulimit i detajuar ne 10 vite paraqitet ne grafikun me posht Duke pasur parasysh sasine e rezervave te llogaritura ne tabelen e mesiperme, per 10 vitet e para, karierra do te zvillohet sipas tabelës prodhimi ne vite i karrieres

Volumi i pergjithshem i zbulimit, i cili do te kryhet ne vite te ndryshme do te depozitohet perkohesisht pjesen e poshtem te karrieres (sheshi +110m ), te krijuar nga shfrytezimi ne vitet e mepareshme brenda kufijve te shfrytezimit (shih vizatimin perkates, Nr.4).

Ne tabelat e meposhteme jepet parashikimi i zbulimit dhe prodhimit ne vite ne shkalle sipas te cilit per 10 vitet e e aktivitetit te shfrytezimit me kapacitet 100000 m<sup>3</sup>/vit .

Grafiku i prodhimit ne shkalle ne 10 vitet e zgjatjes se afatit 2022-2032.





Nr.	Shkalla	Rezerva,m <sup>3</sup>	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	Shuma
1	230	605	605										605
2	220	18975	18975										18975
3	210	46700	46700										46700
4	200	76600	33720										33720
5	190	102200		42880									42880
6	180	123075		57120	40000	25955							123075
7	170	146125			30000	35000	40000	30000	11125				146125
8	160	169850			30000	30045	30000	30000	40000	9805			169850
9	150	204950				9000	30000	30000	40000	50000	45950		204950
10	140	238250					10000	10000	8875	40195	50000	50000	159070
11	130	277915									4050	50000	54050
<b>SHUMA REZERVA</b>		<b>140524</b>	<b>100000</b>	<b>100000</b>	<b>100000</b>	<b>100000</b>	<b>100000</b>	<b>100000</b>	<b>100000</b>	<b>100000</b>	<b>100000</b>	<b>100000</b>	<b>1000000</b>
		<b>5</b>											





### *Jeta e karrieres*

Ne objektin e kerkuar per shfrytezim rezultojne te jene rreth 3.0 milion m<sup>3</sup> rezerva te nxjerrshme te gurit gelqeror. Kapaciteti i podhimit te gurit gelqeror te kerkuar nga shoqeria eshte 100 000m<sup>3</sup>

Bazuar ne keta tregues, jeta e karrieres, duke marre parasysh kapacitetin do te jete mbi 10 vjet. Pavaresisht ketij fakti, ne projektin e hapjes, karriera eshte zhvilluar ne nje pjese te saj.

Sipas grafikut te prodhimit te paraqitur me larte dhe sipas projektit te parashikuar ne karriere llogariten te jene 1.4 milion m<sup>3</sup> rezerva te nxjerrshme, ndersa sipas grafikut te parashikuar prodhim nga karriera do te realizohet 1000 000 m<sup>3</sup>.

Ne keto kushte nga karriera mund te prodhohen edhe me teper nga prodhimi i parashikuar.

### **Radha dhe drejtimi i shfrytezimit dhe grafiket perkates te tyre**

Sikunder duket edhe nga terreni, ne nivelet e poshtem te karrieres, rreth kuotes +130-170m, tereni ka renie te bute dhe lejon germimene ne keto nivele duke paraprire prodhimin paralelisht me hapjen e rruges per ne nivelet e sipërme dhe kryerjen e investimeve Zbankimet qe do te behen ne kete nivel do te krijojne sheshin e depozitimit te sterileve qe megjithese te pakta, kane nevojë per nje shesh depozitimi.

Pas kryerjes se zbulimit ne kete nivel ne vitin e pare ne pjesen mbi shkallen +130m dhe hapjes se rruges per ne shkallet e sipërme ne te gjithë gjatesine e zones se shfrytezimit, kryerjes se skarifikimeve, gerimeve dhe sistemeve te ndryshme, parashikohet te filloje dhe prodhimi i gurit gelqeror ne sasine 100 000 m<sup>3</sup> /vit

Drejtimi i shfrytezimit Drejtimi shfrytezimit te objektit do te jete pergjithesisht nga kufi jugor ne drejtim te atij verior duke filluar nga shkallet aktuale ne drejtim te ngjitje ne perendim te zones. Ne fund te kesaj periudhe do te behet projekti i ri i shfrytezimit mbi rilevimin topografik faktik (sipas projekt programit vjetor).

Orjentimi i pergjithshem i shkalleve do te jete sipas izohipseve te terrenit (shih planimetrine e karrieres ne gjendjen perfundimtare )nga jugu ne veri:

### **Elementet gjeometrike te karrieres ne gjandje perfundimtare**

Duke pasur parasysh pozicionin gjeografik te karrieres, relievin dhe parametrat gjeometrike te shkalleve, karriera do te kete formen e nje stadiumi me zgjatje Juge Veri , me parametrat e me poshtem

1. Thellesia e vertikale e karrieres, 110m;
2. Numuri i shkalleve 11;
3. Gjatesia e karrieres ne plan do te jete rreth 320 m;
4. Gjeresia ne sheshin e poshteme te karrieres (kuota +130 m) , 140m;
5. Kendi i shuarjes se shkalleve ne varesi te shtrirjes se karrieres eshte 63° ;
6. Lartesia e shkalles 10m;
7. Lartesia e fetes se shfrytezimit 2-3m ne fazen fillestare te hapjes se shkalles;
8. Orientimi i transheve te hyrjeve eshte nga jugu ne veri dhe nga qendra per ne Veriperendim dhe Jugeilindje (ne varesi te mbritjes se transhese kryesore)

### **Pasaportat e shpim plasjes per zbulimin dhe fronet e prodhimit llogaritja e lendes eksplozive qe do te perdoret.**

Kryerja e puneve te shpim plasjes, sikunder edhe deri me tani eshte do te realizohet duke patur parasysh faktoret e meposhtem:

- Domosdoshmerine e perdorimit te Lendes Plasese per rrezimin e gelqerorit;



- Volumin ditor ne m<sup>3</sup> masiv, i cili do te jete 320m<sup>3</sup>/dite
- Shpimi i birave ne pjeset fillestare te hyrjes ne shkalle dhe ne hapjen e transheve te cekta do te behet me cekic shpues pneumatik dore;
- Ne mometin e kryerjes se zbulimit ne shkallet e formuara me lartesi 10 m parshikohet te perdoret rrezimit me puse sonde ;

Me poshte jane dhene pasaporta e shpim plasjes per te tre rastet e rrezimit.

### Rrezimi i formacioneve shkembore

Ne llogaritjet e me poshteme do te trajtojme rrezimin e gelqeroreve me puse sonde, dhe rrezimi me dhoma minash metoda te cilat mund te aplikohet ne objekt.

#### Pasaporta e shpim plasjes me bira te shkurtra dore

Parametrat e kesaj shpim plasje e cila do te perdoret gjate hapjes se rruges apo kryerjes se ndonje germimi e sistemimi te nevojshme do jene si me poshte (shif pasaporten e shpim plasajes)

Lartesia maksimale e germimit	3-5 m
Gjatesia e bires	2.2ml
Diametri i bires	38-42 mm
Kendi i skarpates	63-65 °
Distanca nga bira ne bire	1.5 m
Distanca nga buza e skarpates ne bire	1.2 m
Vija e rezistences me te vogel	2-2.2 m
Ngarkesa e Lendes Plasese per bire	1.8 kg
Volumi maksimal i hedhur bire	6 m <sup>3</sup>
Konsumi specifik i lendes plasese	0.35 kg /m <sup>3</sup> masiv

Birat do te jene vertikale

Per mbushjen e birave parashikohet te perdoret amonit malor.

Ne rastet e rrezimit me bira sondash parametrat e pasaportes se shpim plasjes do te jene si me poshte

Lartesia e shkalles	10 m
Gjatesia e bires	11ml
Diametri i pusit te sondes	100 mm
Kendi i skarpates	68-73°
Distanca nga bira ne bire	3 m
Distanca nga buza e skarpates ne bire	3.5 m
Vija e rezistences me te vogel	6- 6.5 m
Ngarkesa e Lendes plasese per bire	68.25 kg
Volumi mesatar i hedhur per pus sonde	240-260 m <sup>3</sup>
Konsumi specifik i lendes plasese	0.35kg /m <sup>3</sup> masiv

Birrat do te jene vertikale

Ne raste te pershtateshme mund te perdoren dhe bira te pjerrta me kend pjerresie 75°

Sasia e lendes plasese per 1 pus sonde eshte llogaritur si me poshte :

$$Q = 0.34x axWxH = 0.35x 3 x 6.25 x 10 = 64 \text{ Kg}$$

**Ku:**

**Q** -Sasia e L.P per cdo pus sonde ne Kg



**0.34** -Koeficient praktik i eksperiencës në formacione analoge të zonës

*a* - Distanca midis birave në ml 3 ml

*W* - Vija e rezistencës me të vogël 6-6.5 m

*H* - Lartësia e shkallës 10 m

### **Mbushja e puseve të sondës me lëndë plasëse, taposja dhe shperthimi i tyre.**

Shperthimi i puseve të sondës do të bëhet me dy mënyra:

1. Shperthimi me kapsolla elektrike milisekondare të lidhura në seri me kohe vonese 25 ms në rrjeshtin pasardhës, kur shperthehen njëherësh disa rrjeshta. Shperthimi i rrjetit elektrik do të bëhet me aparat shperthimi ose me gjenerator.

2. Shperthimi me fitil detonant. Ngarkesa e lëndës plasëse që vendoset në puset e sondave kur shperthimi bëhet elektrik përbehet nga :

Ngarkesa e bazës me lëndë plasëse

Ngarkesa e kollonës me lëndë plasëse

Kapsollet elektrike

Rrjeti i shperthimit.

Volumi i gelqerorit në masiv do të jetë:

$$V = H \times (4 + 5) \times (8 + 10) = 10 \times 9 \times 18 = 1620 \text{m}^3$$

Sasia e lëndës plasëse për një shperthim do të jetë :

$$Q = n \times q \quad \text{kg}$$

*n*- numri i birave në shkallë 9 birra

*q*- lenda plasëse që vendoset në një birë 1 kg

$$Q = 9 \times 1 = 9 \text{ kg}$$

Numri i kapsollave elektrike për një shperthim është 9 cope.

Sasia e lëndës plasëse:

$$Q_2 = N \times Q \quad \text{kg}$$

*N*- numri i shperthimeve

$$N = \frac{\ddot{e} + L_1 + (2 \times 1.2)}{L_2} : 1.12 = (6.5 + 6.5 + 2.4) : 1.12 = 14 \text{ cikle}$$

$$Q_2 = 14 \times 9 = 126 \text{ kg}$$

Për rrezimin e formacioneve do të perdoret lenda plasëse amonit ose dinamit me diametër të fishekut 32 mm dhe gjatësi 200 mm. Numri i kapsollave do të jetë 126 cope.

Ngarkesa e lëndës plasëse që do të vendoset në dhomat e minave do të jetë:

$$Q_3 = V \times q_1 \quad \text{kg}$$

*V* - Volumi i gelqerorit që do të shkruftohet

*q*<sub>1</sub> – konsumi i lëndës plasëse që do të shkruftohet 0.3 kg/ m<sup>3</sup>



$$Q_3 = 1620 \times 0.3 = 486 \text{kg.}$$

Sasia e lëndës plasëse që do të vendoset në një dhomë do të jetë :

$$Q_4 = 486 : 2 = 243 \text{ kg.}$$

Sasia e lëndës plasëse që do të shperthej njëherësh do të jetë 243 kg.

*Me poshte eshte paraqitur plan vendosje e birave te sondes dhe radha e shperthimit te tyre*



## PASAPORTA E SHPIM - PLASJES ME BIRA TE SHKURTRA DORE

Shkalla 1 : 50





Tabela e treguesave te rrezimit me bira te shkurtra minash

Nr	Emertimi	Simboli	Njesi	Vlera
1	Lartesia e shkalles	H	m	10
2	Lartesia e nenshkalles	h	m	2
3	Gjatesia e bires	$h_b$	m	2.2
4	Diametri i bires	$\phi$	mm	38 - 42
5	Kendi i skarpates	$\alpha$	grade	70 - 72
6	Distanca nga bira ne bira		m	1.5
7	Distanca nga buza e skarpates se sipërme ne bira	a	m	0.8
8	Distanca nga bira tek buza e skarpates se poshtme	c	m	1.2
9	Vija e rezistencos me te vogel	W	m	2.2
10	Ngarkesa e lendes plasese per bira		Kg	1.8
11	Volumi maksimal i hedhur per bira		$m^3$	8
12	Numri maksimal i birave ne nje shperthim		cope	deri 120
13	Menyra e shperthimit		Me zjarr ose elektrike	



Permbledhja e te dhenave me te rendesishme.

Nr.	Kushtet dhe treguesit e shpim-plasjes	Njesi matje	Sasia
1	Lartesia e shkalleve te karrieres	m	10
2	Thellesia e bires sondes	m	11.44
3	Vija e rezistences minimale	m	3.11
4	Distanca midis rreshtave	m	3.11
5	Distanca midis birave ne rresht	m	4
6	Drejtimi birave		Paralel me skarpaten
7	Podhim per 1ml bire sdonde ne masiv	m <sup>3</sup>	12.44
8	Ngarkesa e bires me lende plasese Anfo	Kg	30
9	Ngarkesa e bires me lende plasese Power Gel Magnium 365	kg	14.9
10	Numri kapsolleve milisekondare NONEL ne nje shperthim me nje rresht	cope	13
11	Numri kapsolleve milisekondare NONEL ne nje shperthim me tre rreshta	cope	39
12	Detonatoret lidhes EKSEL ML lidhje ne tuf me tre cope kapsolla	cope	13
13	Kapsolle e zakonshme	cope	1
14	Fitali i zakonsham	ml	2
15	Konsumi specifik i lendes plasese	Kg/m <sup>3</sup>	0.36
16	Shpimi specifik meter linear bire per m <sup>3</sup>	ml/m <sup>3</sup>	0.092

Parametrat e mesiperm te pasaportave te shpim plasjes jane orientues, te bazuar ne eksperiencen e kryerjes se puneve me lende plasese ne guroret dhe karrierat e ndryshme te rajonit ne shkembinj me karakteristika te peraferta dhe mund te korigjohen gjate kryerjes se punimeve faktike te shpim plasjes ne kushtet reale te karrieres sone

Volumi i pritshem qe do te zhvendoset pas shperthimit te 10 puseve te sondes do te jete 3800-4000 m<sup>3</sup> te shkrifet.

Parametrat e mesiperm te pasaportave te shpim plasjes jane orientues, te bazuar ne eksperiencen e kryerjes se puneve me lende plasese ne guroret dhe karrierat e ndryshme te rajonit ne shkembinj me karakteristika te peraferta dhe mund te korigjohen gjate kryerjes se punimeve faktike te shpim plasjes ne kushtet reale te karrieres sone

Ne mbushjen e birave me lende plasese mund te perdoret, pervec amonitit malor, dhe ANFO, duke zbatuar ligjin e te drejtes se prodhimit te lendes plasese, e cila jepet me leje te posaçme nga Ministria e Mbrojtjes.

Shpimi i birave do te behet me diameter  $\Phi$  80 mm deri 110 mm dhe drejtim paralel me shpatin e shkalles se karrieres.

Diametri i shpimit eshte i zgjedhur mbeshtetur ne dimensionin e copave per mjetet e ngarkimit qe parashikohet te perdoren mbeshtetur edhe ne pervojen e shfrytezimit te karrierave ne vendin tone.

Eshte zgjedhur shpimi i pjerret ose me nje kend prej  $i=15^\circ$  pasi sipas teknikave te reja te punes me lende plasese, pjesa e shpimit gjate plasjes prodhon vale lekundese, qe duke u perhapur ne drejtim normal te aksit te pusit, arrin ne siperfaqen e lire duke bashkepunuar ne menyre efikase me shkembinj per thyerjen e tij. Ne shpimet vertikale eshte vertetuar nga perdorimet praktike,

por edhe nga llogaritjet teorike, se ndodh fenomeni qe energjia e prodhuar, perhapet ne trajte vibracionesh.

Shpimet e pjerreta realizojne nje drejtim te shpatit te shkalles ne kendin e deshiruar

- Shpimet do te behen ne dy rreshta, ne rreshtin e pare do te behen 7 puse dhe ne rreshtin e dyte 6 puse. ne formen e kutise se shahut duke formuar nje trekendesh barabrinjes me brinje 4.2 m.
- Distanca midis rreshtave do te jete 3.7 m distanca qe trajtohem me poshte tek kapitulli i pasaportes se shpim plasjes.

Nga shperthimi llogritet te rrezohen rreth  $13 \times 176 = 2288 \text{ m}^3$  ose 4804.8 ton gelqeror, prodhim i gatshem per 15 dite prodhim Pasaporta e shpim-plasjes jepet ne studim se bashku me treguesit perkates.

Gjithashtu, pervec procesit te mesiperme subjekti ka dhe linjen e fraksionimit te gurit gelqeror. E gjithes sasia qe do te merret nga gurorja do te dergohet ne impiantin e fraksionimit te ketij subjekti. Siperfaqja e ketij impianti eshte  $3300 \text{ m}^2$ .

#### **Impakti ne mjedis si rezultat i aktivitetit dhe masat e marra:**

Procesi i fraksionimit ne impiant konsiston ne prodhimin e inerteve me pas perdorimin per kerkest e tregut. Inertet e gurit gelqeror shërbejnë si lëndë e parë dhe si produkt i prodhimit.

Lenda e pare, pra inertet me granulometri te ndryshme nga vendi i depozitimit te tyre ngarkohen me anë të fadromave në mjetet e transportit, këto mjete e shkarkojnë këtë material në bunkerin kryesor te inerteve.

Prodhimi i inerteve i cili realizohet në impiantin e fraksionimit realizohet guret gelqerore te nxjerre nga karriera e shoqerise, te cilet nuk kane shkarkime te ngurta industriale, dhe kane impakt te moderuar ne mjedisin rrethues. Konkludojmë që në procesin e fraksionimit te inerteve produktet qe te dalin si mbetje sterile te ngurta apo ne forme gazesh e pluhuri, jane brenda normave sepse kompania mban ne mbikqyrje dhe kryhen ne vazhdimesi sperkatjen me uje. Disa nga mbetjet perdoren per stabilizante ne pika te dobta te territorit.

Gjithashtu procesi teknologjik që zhvillohet aty është proces i cili nuk ka të bëjë me ndryshimin kimik të lëndës, por vetëm me ndryshimin fizik e mekanik të saj. Në këtë proces nuk përdoren kimikate apo lëndë të tjera të cilat mund të përbëjnë premisa për të shkarkuar elementë ndotës në mjedis.

Ushqyesi ben furnizimine me material te frontos, i cili ben thyerjen e pare te materialit. Materiali i thyer me transportier transportohet per ne mulli ne te cilet behet thyerja e me te jshme deri ne realizimin e fraksioneve te kerkuara. Pas thyerjes me transportier materiali kalon ne disa sita ne te cilet kryhet ndarja ne fraksionet e kerkuara dhe prodhimi i inerteve te fraksionuara.. Në prodhimin e inerteve, proces i thjeshtë mekanik bluares, futen gure te madhesise te ndryshme qe pas bluarjes kalojne ne transportier dhe gjate ketij procesi perdoret uje, procesi teknologjik që zhvillohet nuk ka të bëjë me ndryshimin kimik të lëndës, nuk do të përdoren kimikate apo lëndë të tjera të cilat mund të përbëjnë premisa për të shkarkuar elementë ndotës në mjedis. Përsa i takon emetimit të zhurmave, ato janë zhurma vetëm brënda normave të lejuara. Aktiviteti i fraksionimit ka si shkarkim, emetimin e gazeve që dalin nga puna e mjeteve levizese si fadromës dhe makinave të transportit. Këto mjete janë të kolauduara dhe për pasojë emetimet e tyre janë brënda normave të lejuara.



## 2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI

Zona ku kerkohet te behet shtyrja ne afat i lejes minerare te shfrytezimit ndodhet ne shpatin Lindor te vargmalit te Heremecit ne vendin e quajtur Volloderi i Siperm.

Zona, objekt i lejes minerare te shfrytezimit ndodhet ne te majte te rruges nacionale Sarande – Vlore ne nje distance rreth 320 larg ne vije ajrore.

Zona qe kerkohet per shtyrje ne afat te lejes minerare te shfrytezimit ka keto kordinata:

Koordinatat e objektit

Nr.	Y	X
1	44 15455	44 18 127
2	44 15 295	44 18 497
3	44 15 545	44 18 597
4	44 15 695	44 18 227
Sipefaqe e objektit 0.106 km <sup>2</sup>		


Sipefaqja e zones eshte 0,106 km<sup>2</sup> dhe shfrytezimi nuk shkakton demtime ne mjedis, apo probleme sociale.

Harta Topografike 1:10 000





**HARTA TOPOGRAFIKE ME KONTURET E LEJES MINERARE NR. 661/1  
OBJEKTI "VOLLODER I SIPERM", SARANDE  
Shk 1: 25 000**





Aktiviteti do të zhvillohet në qarkun e Vlores , rrethi Sarandë, në komunën Lukovë në fshatin Nivicë-Bubari. Vlorë ndodhet përgjatë brigjeve shqiptare të detit Adriatik dhe Jon në pjesën lindore të ngushticës së Otrantos, e rrethuar nga ultësirat e maleve Cerauniane. E përcaktuar në një sipërfaqe prej 647,94 km<sup>2</sup>, Bashkia Vlorë përfshihet në qarkun e Vlorës si pjesë e Rajonit Jugor të Shqipërisë dhe përbëhet nga njësitë administrative ngjitur Novoselë, Orikum, Qendër Vlorë, Shushicë dhe Vlorë. Bashkia shtrihet nga gryka e Vjosës në veri përgjatë Lagunës së Nartës deri në Qafën e Llogarasë në jug. Ai gjithashtu rrethon gadishullin e Karaburunit dhe ishullin e Sazanit në perëndim me lumin Shushicë-Vlorë që përbën kufirin e tij lindor. Zonat e mbrojtura përfshijnë Parkun Detar Karaburun-Sazan, Parkun Kombëtar të Llogarasë dhe Peizazhin e Mbrojtur Vjosë-Nartë. Bashkia Sarandë përfshihet në qarkun e Vlorës si pjesë e Rajonit Jugor të Shqipërisë dhe përbëhet nga njësitë administrative ngjitur me Ksamilin dhe Sarandën. Sipërfaqja e përgjithshme e saj është 58,96 km<sup>2</sup>. Nivicë-Bubari ndodhet në rrethin e Sarandës në rrëze të malit Shëndëlli në pjesën lindore të tij në lartësi 400 m mbi nivelin e detit. Ka 260 shtëpi dhe rreth 1600 banorë. Është fshati i parë që takon në rrugën nacionale Sarandë-Vlorë gjatë bregut të detit në një distancë rreth 14 km prej qytetit të Sarandës.

#### ❖ Klima

Vlorë bie nën periferinë e zonës së klimës mesdhetare të verës së nxehtë me një temperaturë mesatare vjetore prej 16,9 °C. Vera në Vlorë është e thatë dhe e nxehtë ndërsa dimrat përjetojnë temperatura mesatare dhe mot të ndryshueshëm me shi. Muaji më i ngrohtë është gushti me një temperaturë mesatare që rritet në 26,8 °C . Në të kundërt, muaji më i ftohtë është janari me një temperaturë mesatare që bie në 7,9 °C (46,2 °F). Vlorë ka një klimë me diell me një mesatare prej 3,358 orë me diell në vit, duke e bërë atë një nga zonat më me diell në Mesdheun Lindor.

Relievi i butë ka pamjen e një pllaje të vazuar, vende-vende pak të thyer me lugina të buta të formuara nga prroskat e rrjedhjes së ujërave atmosferike. Zona është në përgjithësi e pasur me ujë, pranë kalon lumi Erzen që derdhet në dete dhe janë ndërtuar disa ujëmbledhës të cilët plotësojnë kërkesat e komunitetit për ujë të tokave bujqësore.

#### ❖ Flora dhe fauna

Pyjet e zonës ofrojnë mjedise të favorshme për rritjen e bimëve dhe kafshëve të ndryshme. Kultivohen bime të ndryshme bujqësore si perime, drithëra, kultura foragjere etj, gjithashtu kultivohen druret frutore të zonës së Mesdheut si: agrumet (portokallet, limonat, mandarinat) dhe ullinjtë. Vreshtaria zë vend të parësor.

Bimët barishtore dhe eterovajore që shërbejnë në mjekësinë popullore dhe farmaceutike shtrihen nga zona fushore e deri në atë malore.

Në zonën e shkurreve rritet valanidhi dhe perralli, të njohur për vlerat kurative.

Në lartësinë 800m mbi nivelin e detit, shtrihet zona e dushkut. Mbi 800m mbi nivelin e detit gjendet zona e pishave dhe bredhit si dhe bushi e shtogu.

Kullotat subalpine gjenden në lartësinë 700-1800m.

Fauna dhe eritrofauna është e pasur në lloje në gjithë zonën: sorkadhja, derri i eger, ujku, çakalli dhelpra, lepuri i eger (sidomos në pyllin e Llogorait), eritrofauna e pasur si në toke ashtu edhe

ne ujera: kukapiku, harabeli, mellenja, laraska, zhgaba, skifteri, petriti, thellezat, pellumbat e eger, shapkat (liqeni i Orikumit). Jo rralle shfaqen dhe delfinet e Mesdheut. Zona e Vlores pret te pakten 33 lloje qe meritojne mbrojtje prej te cileve 14 te vleresuar si te rrezikuar per t'u zhdukur, si foka murgeshe mesdhetare (Monachus Monachus), breshka (Caretta Caretta), tritoni i kreshperuar (Triturus Cristatus) pelikani me krrela (Pelecanus Crispus), shqipja me bllama (Aquila clanga). Ne dimer me shume se 23% e gjithe zogjve ujore te Shqiperise strehohen ketu.

### **3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS**

- **Ndikimet ne popullsi**

Ushtrimi i aktivitetit do te kryhet larg zonave te banuara, rreth 1 km (ne vije ajrore) nga vendbanimet me te aferta. Vendi ku do te zhvillohet aktiviteti nuk sjell shqetesime per ta vecse rrit mundesine e punesimit te tyre, duke rritur keshtu nivelin ekonomik te ketyre familjeve qe ndodhen ne fshatin prane.

- **Ndikimet nga zhurmat**

Vleresojme se niveli akustik i zhurmes ne rruge eshte me i ulet se ai i zhurmes se nje makine qe kalon ne te , praktikisht ai eshte 40-50 dB qe i pergjigjet kushteve te nje bisede me ze normal.

Analiza e frekuences te zhurmes te emetuar nga keto makineri dhe pajisje tregon se ato ndodhen nen mesataren e frekuences 200-2000Hz , e cila e shte e pranueshme nga veshi i njeriut .

Gjate shfrytezimit te objektit perdorimi i lendes plasese nuk do te kete ndonje efekt ne mjedis si per lekundjet sizmike ashtu dhe per zhurmat dhe valen goditese

- **Ndikime nga shkarkimi i ujerave**

Teknologjia shfrytezimit te objektit nuk parashikon perdorimin e ujit . Ujrat e reshjeve do te dekantohen negropa brenda zones se shfrytezimit. Rrjedhja e me tejshme e tyre do te behet ne perputhje me rrjedhen natyrale te tyre me ane te nje kanali ne ane te rruges se hapjes deri ne kanal in e rruges se poashteme

- **Ndikimet ne toke**

Siperfaqja e pergjitheshme qe do te zeje objekti gjate shfrytezimit eshte 0.106 km<sup>2</sup>. Ajo nuk eshte e kultivueshme dhe nuk perfaqeson ndonje kullote . Ne prefundim te shfrytezimit kjo siperfaqe do te sistemohet dhe mbillet me qellim riperdorimin e saj. E gjithe zona do te mbulohet me formacionet deluviale te zbulimit duke mundesuar keshtu, pas perpunimit, kultivimin e pemeve te ndryshme lokale dhe barishteve

Si rrjedhim pas shfrytezimit nuk do te kemi humbje te siperfaqes per kullote.

- **Ndikimet ne ajer**

Duke qene se kemi te bejme me nje aktivitet karriere, kemi nje gjenerim te pluhrave ne ajer por qe nuk shkaktojne ndotje te nje niveli shqetesues. Per ta evituar, here pas here subjekti ben sperkatje me uje te territorit. Me qene se projekti parashikon rrezimin e materialit me perdorim

te lende plasese, proceset e rrezimit dhe ngarkimit do te shoqerohen me sperkatje per parandalimin e pluhurit.

- **Pershkrimi i ndikimeve negative individuale dhe te grumbulluara ne biodiversitet duke perfshire ndikimet nderkombetare**

Nga zhvillimi i aktivitetit, ne zonen ku zhvillohet dhe territorin per rreth, nuk ka dhe nuk jane parashikuar ndikime individuale apo te grumbulluara ne biodiversitet. Objekti eshte ne brendesi te territorit te Republikes se Shqiperise, prandaj dhe nuk ka ndikime nderkufitare.

- **Ndikimet ne perdorimin e tokes**

Aktiviteti ne fjale eshte i pajisur me nje leje minerare, dhe per kete arsye ne perfundim te shfrytezimit te kesaj siperfaqe toke, do beje rehabilitimin e saj. Ky aktivitet nuk ka ndikime negative ne perdorimin e tokes, nuk do te perdoret siperfaqe tjeter toke pervec asaj te miratuar per kete qellim.

- **Ndikimet ne ekonomi**

Persa I perket ndikimeve ekonomike ky aktivitet duke qene aktivitet I nxjerrjes se mineraleve te reres dhe argjiles sjell ndikime pozitive ne ekonomi duke rritur te ardhurat jo vetem te investitorit por duke punesuar edhe punonjes nga zona perreth rrit nivelin e tyre te jete. Mund te themi qe mineralet qe perftohen nga ky aktivitet mund te perdoren si lende te pare per procese te tjera ne sektorin e ndertimit dhe per kete arsye eshte nje aktivitet qe ka ndikime pozitive ne ekonomine e vendit tone.

#### **4. MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE**

Me qellim qe te parandalohen ,shmangen minimizohen dhe kontrollohen ndikimet negative mjedisore te aktivitetit gjate zhvillimit te tij, investitori duhet te marre masat e duhura per mbrojtjen e mjedisit.

##### **❖ Gjelberimi i territorit**

Per reduktimin e pluhurave nga ana e shoqerise behet sperkatja e vazhdueshme, sidomos gjate stines se thate te veres.

##### **❖ Mbetjet e ngurta**

Sasi e sterileve te zbulimit, perkohesisht do te depozitohet ne siperfaqet e parashikuara ne projekt dhe me vone do te ritransportohen dhe depozitohen ne sheshet e shkalleve dhe ne sheshin e poshtem +130m. Ato perfaqesohen nga deluvione te shkriфта, qe nuk permbajne elemente ndotes per ambientin . Keto depozitime jane fertile dhe do te sherbejne me se miri per rigjenerimin e karrieres.

Ne projekt eshte parashikuar nje radhe dhe drejtimi i tille i shfrytezimi, qe ne kombinim me masat e tjera suplementare te mbushjes, sistemimit dhe trajtimit, parandalojne erozionin, shembjen dhe vithisjen e shapateve te karrieres dhe siperfaqes se tokes rreth saj

### ❖ Kushtet e punes

Investitori ka krijuar kushte te favorshme pune per punonjesit e tij. Per te permbushur sigurine e punetoreve ofron kushte te mira pune, punetoret jane te pajisur me uniforma. Stafi eshte me eksperience ne kete fushe. Janë marrë masa për sigurimin teknik dhe sistemimin e ambienteve të punës.

### ❖ Vleresimi i efektivitetit te pritshem te masave zbutese

Realizimi i objektivave dhe treguesve te pritshem te parashikuar ne projekt do te varet nga respektimi i te gjithe treguesve te percaktuar. Kontrolli, monitorimi dhe permiresimi i vazhdueshem i kushteve te punes do te çojne ne siperfaqe te pastra, te sistemuara e te gjelberuara.

## 5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

### ❖ Konkluzione

- Zbatohen rregullat e sigurimit teknik. Punetoret njihen me keto rregulla ne menyre periodike nga drejtuesi teknik te firmes.
- Mbjajtja paster e mjedisit te territorit, eshte detyre e perhershme ne menyre qe te sigurohet nje mjedis sherbimi i kulturuar dhe cilesor.
- Vlerësohet puna e bërë nga drejtuesit e ketij subjekti.
- Riparimet e mjeteve te renda dhe atyre te transportit kryhen ne vende te vecanta duke marre masa per uljen e ndikimit ne mjedis dhe per te mos lejuar kontaminimin mjedisor me mbetje te lubrifikanteve.

### ❖ Rekomandime

- Te vazhdohet te kontrollohen, pastrohen dhe mirembahen ambientet e punes.
- Te vazhdohet te kryhet rregullisht kontrolli i gjendjes teknike te agregateve teknologjike te mbrojtjes se mjedidit dhe mjeteve te transportit..
- Te merren masa dhe te kryhet rehabilitimi i mjedisit ne rastet e ndonje aksidenti.

